




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u mbështetur në nenin , 7 paragrafi 1, pika 1.1, 1.11, 1.12, 1.17 dhe 1.24 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/L-055), në mbledhjen e mbajtur më datën 12 dhjetor 2019, miraton këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr.03/2019 PËR RREGULLAT UNIKE DHE TË PËRBASHKËTA PËR RENDIN SHTËPIAK NË GJYKATA**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të vendosë një sistem të rregullave unike dhe të përbashkëta të rendit shtëpiak në tërë Gjykatat e Kosovës.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Me këtë udhëzim përcaktohen rregullat e sjelljes dhe qasjes së të gjithë personave që kërkojnë qasje në objektet e Gjyqësorit.
2. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet ndaj gjyqtarëve, personelit administrativ gjyqësor, personelit teknik të gjykatave, palëve në procedurë gjyqësore dhe palëve të tjera të interesuara.
3. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për qasje në objektin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykatave dhe degëve të tyre, sipas Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Përkufizimet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin siç është përcaktuar më poshtë:

1.1. ‘Gjykatë’ - nënkupton çdo gjykatë të rregullt të Republikës së Kosovës siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-054 për Gjykata.

1.2. “Degë e Gjykatës” - nën-ndarja gjeografike e një Gjykate Themelore, siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-054 për Gjykata.

1.3. ‘Objekt i Gjykatës’ - nënkupton çdo objekt, ndërtesë apo hapësirë tjetër, e përcaktuar sipas ligjit apo rregullave në të cilën kryhen funksionet gjyqësore.

1.4. ‘Palë në procedurë gjyqësore’ - nënkupton çdo person fizik dhe juridik, që në çfarëdo cilësie paraqitet si palë në procedurë gjyqësore.

1.4.1. Në kuptim të këtij paragrafi, palë në procedurë gjyqësore konsiderohen palët të parapara sipas legjislacionit në fuqi.

1.5. ‘Palë e interesuar’ - nënkupton çdo person, qoftë fizik apo juridik, që nuk është palë në procedurë gjyqësore, por që dëshmon interes legjitim për qasje në objektet e Gjykatave.

1.5.1. Në kuptim të këtij paragrafi, palë të interesuara konsiderohen:

1.5.1.1. Përfaqësuesit e institucioneve, delegacionet shtetërore vendore dhe të huaja, donatorët, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e mediave dhe gazetarët e akredituar, monitoruesit e punës së gjykatave, studentët, praktikantët, mysafirët (vizitorët), publiku i përgjithshëm (gjerë) si dhe palët tjera që shfaqin interes të ndjekin seancat gjyqësore (dëgjimore).

1.6. ‘Interes legjitim’ - nënkupton çdo leje, ftesë, autorizim apo miratim tjetër, i dhënë shprehimisht apo në mënyrë tjetër, me të cilin dëshmohet interesi i palëve të interesuara për qasje në objektet e Gjykatave.

1.7. ‘Zyrtar i sigurimit’ - nënkupton personin zyrtar i autorizuar sipas ligjit apo rregullave për të ofruar shërbime të sigurisë në objektet e Gjykatave.

1.8. ‘Hapësirë e përbashkët e Gjykatës’ - nënkupton çdo hapësirë, të kufizuar apo të pakufizuar, në të cilën është e lejueshme qasja e përbashkët dhe e pakufizuar e të gjithë personave.

1.8.1. Në kuptim të këtij paragrafi, hapësirë e përbashkët e Gjykatës konsiderohet:

1.8.1.1. Salla e gjykimeve (gjykatorja), zyra për menaxhimin e lëndëve, hapësirat e përbashkëta të pritjes, hapësirat ku bëhen shpalljet publike, ashensorët, tualetet, pijetoret (bufetë), korridoret dhe shkallët e gjykatave.

1.9. ‘Hapësirë e veçantë e Gjykatës’ - nënkupton çdo hapësirë, të kufizuar apo të pakufizuar, në të cilën nuk është e lejueshme qasja e përbashkët dhe e pakufizuar e të gjithë personave, por kërkon leje apo autorizim të veçantë.

1.9.1. Në kuptim të këtij paragrafi, hapësirë e veçantë e Gjykatës konsiderohet:

1.9.1.1. Zyra e Kryetarit të Gjykatës, zyra e nën-Kryetarit të Gjykatës, zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës, zyra e Administratorit, zyra e Zëvendës-Administratorit, zyrat e Gjyqtarëve, lokacionet e dedikuara për avokatë, dëshmitarët e mbrojtur, të paraburgosurit, dhoma e evidencave, si dhe zyra e personelit të sigurimit.

1.10. ‘Komunikimi *ex-parte*’ - nënkupton çfarëdo forme të komunikimit ndërmjet një gjyqtari dhe njëres prej palëve në procedurë gjyqësore apo një palë tjetër lidhur me rastin konkret gjyqësor, pa prezencën, pjesëmarrjen ose dijeninë e palës tjetër ndërgjyqësore.

1.11. ‘Person i autorizuar’ - nënkupton Kryetarin e Gjykatës apo ndonjë person tjetër të autorizuar nga Kryetari i Gjykatës në mbështetje të Nenit 5.1. të këtij Udhëzimi.

#### **Neni 4**

##### **Parimet e përgjithshme dhe udhëzuese të qasjes në objektet e Gjykatave**

1. Qasja në objektet e Gjykatave do të udhëhiqet nga këto parime të përgjithshme dhe udhëzuese:

- 1.1. Parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit
- 1.2. Parimi i trajtimit të dinjitetshëm
- 1.3. Parimi i proporcionalitetit
- 1.4. Parimi i punës së hapur (publicitetit) dhe transparencës.

#### **Neni 5**

##### **Përgjegjësia për zbatim dhe sanksionet**

1. Në parim, përgjegjësia për zbatimin e rregullave unike dhe të përbashkëta për rendin shtëpiak në Gjykata është nën autoritetin përfundimtar administrativ të Kryetarëve të Gjykatave sipas



autorizimeve ligjore. Përbashimisht, në pamundësi objektive për ushtrimin e autoritetit administrativ apo në bazë të delegimit, kjo përgjegjësi mund të ushtrohet edhe nga personat e tjerë të autorizuar shprehimisht apo në mënyrë tjetër nga Kryetarët e Gjykatave.

2. Me qëllim të zbatimit të rregullave unike dhe të përbashkëta për rendin shtëpiak, Kryetarët e Gjykatave mund të nxjerrin vendime dhe urdhëresa zbatuese.

3. Me qëllim të zbatimit dhe fuqizimit të rregullave unike dhe të përbashkëta për rendin shtëpiak në Gjykata, në rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, gjetjes së armëve gjatë kontrollit, kundërshtimit të urdhrave me shkrim dhe gojë, zyrtarët e sigurimit mund të përdorin masat e nevojshme dhe te përshtatshme ligjore.

4. Shkelja e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ nga ana e punonjësve të gjyqësorit krijon bazë për masë disiplinore, ndërsa për palët, largimin nga objekti dhe në raste të caktuara raportimi i rastit në polici.

## **II. QASJA NË OBJEKTET E GJYKATAVE**

### **Neni 6**

#### **Koha dhe vendi i hyrjes në objektet e Gjykatave**

1. Hyrja në objektet e Gjykatave do të bëhet gjatë orarit zyrtar të punës (08:00 – 16:00) të shpallur publikisht dhe të vendosur në një vend të dukshëm apo në kohën kur kjo lejohet nga personi i autorizuar.

2. Hyrja në objektet e Gjykatave do të përcaktohet nga Kryetari/ja e Gjykatës ose zyrtarit të caktuar nga Gjykata për këtë çështje.

3. Palët do të udhëzohen lidhur me qasjen në Gjykata nga personeli i sigurimit në Gjykatë.

4. Përdorimi i shkallëve emergjente të Gjykatave lejohet vetëm për rastet emergjente të cilat përcaktohen me ligj.

5. Gjykata duhet të sigurojë qasje të lehtë në sallën e gjyqësorit për persona me aftësi të kufizuara.

6. Të miturit duhet të kenë qasje në Gjykata, sipas Ligjit për Gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kur është e nevojshme dhe sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 7**

#### **Lejimi i hyrjes në objektet e Gjykatave**

1. Gjyqtarët, personeli administrativ gjyqësor dhe personeli teknik i gjykatave lejohet të hyjnë në objektet e Gjykatave gjatë gjithë orarit zyrtar të punës dhe kohës së autorizuar nga personi i autorizuar, në bazë të dokumentit zyrtar të identifikimit të lëshuar nga organi kompetent. Personeli

Gjyqësor, është obliguar të mbajë dokumentet identifikuese gjatë gjithë orarit të punës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të prodhojë dhe lëshojë në përdorim dokumentet identifikuese për gjyqtarë, personelin e Gjykatave, palët në procedurë gjyqësore dhe palët e interesuara. Dokumentet (kartelat) identifikuese duhet të bëhen sipas Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Palët në procedurë gjyqësore lejohet të hyjnë në objektet e Gjykatave në bazë të thirrjes (ftesës) gjyqësore, në kohën dhe vendin e përcaktuar në thirrjen (ftesën) gjyqësore. Përveç thirrjes (ftesës) gjyqësore, palët në procedurë gjyqësore duhet të bartin me vete edhe një dokument valid identifikimi.

3. Palët e interesuara lejohet të kenë qasje në të gjitha hapësirat e përbashkëta të gjykatës. Ndërsa, për qasje në hapësirat e kufizuara, palët e interesuara duhet të dëshmojnë një interes legjitim. Palët e interesuara duhet të identifikohen përmes një dokumenti valid të identifikimit.

4. Përfaqësuesit e organeve të zbatimit të rendit dhe të sigurisë publike lejohet të hyjnë në objektet e gjykatave gjatë gjithë orarit zyrtar të punës, kur kjo është e arsyeshme dhe e domosdoshme.

5. Gjyqtarët gjatë hyrjes në objektet e Gjykatave dhe gjatë gjithë orarit zyrtar të punës duhet të kenë paraqitje dhe veshje serioze, në mënyrë që të përfaqësojnë sa më denjësisht Gjykatat.

6. Personeli administrativ gjyqësor dhe personeli teknik i Gjykatave gjatë hyrjes në objektet e Gjykatave dhe gjatë gjithë orarit zyrtar të punës duhet të kenë paraqitje dhe veshje serioze dhe të zbatojnë kodin e veshjes të përcaktuar me Kodin e Mirësjelljes për Personelin Administratës Gjyqësore dhe Udhëzuesin për Implementimin e Kodit (shtojca 1 e Kodit) të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mënyrë që të përfaqësojnë sa më denjësisht Gjykatat.

7. Qasja në Gjykatë për vizitorë dhe palë në procedurë gjyqësore nuk lejohet në rast se këta të fundit posedojnë veshje jo-etike në përputhje me kodin e veshjes, sikurse është e përcaktuar me rregullore për zyrtarët e gjykatës.

## **Neni 8**

### **Zbatimi i kontrolleve të sigurisë dhe artikujt e ndaluar**

1. Kontrollat e sigurisë zbatohen nga personeli për sigurim në Gjykata. Kontrolli duhet të jetë i arsyeshëm dhe të zbatohet në atë mënyrë që të mos cenohet dinjiteti njerëzor.

2. Me rastin e hyrjes në objektet e Gjykatave, të gjithë personat duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë me qëllim të parandalimit të futjes së artikujve apo gjësëndeve të pa-autorizuara sipas ligjit apo rregullave. Përrjashtimisht, kontrollat e sigurisë nuk do të zbatohen ndaj përfaqësuesve të organeve të zbatimit të rendit dhe të sigurisë të cilët janë në detyrë zyrtare dhe që sipas ligjit apo rregullave janë të autorizuar të bartin armë të zjarrit.

3. Nëse përfaqësuesit e organeve të zbatimit të rendit dhe të sigurisë, janë të ftuar si palë në procedurë gjyqësore, dhe jo si përfaqësues të organeve shtetërorë, duhet të sigurohet mos-bartja e uniformës dhe armës (revoles) në objektin e gjykatës.

4. Kontrollat e sigurisë, duhet të zbatohen me rastin e mbajtës së seancave gjyqësore, dhe me atë rast personeli për siguri duhet përdorur mjete apo pajisje të specializuara të kontrollit të sigurisë.

5. Refuzimi për t'iu nënshtuar kontrolleve të sigurisë përbën bazë të mjaftueshme për ndalimin e qasjes/hyrjes në objektet e Gjykatave dhe largimit të tyre nga objekti

6. Ndalohet rreptësisht bartja e artikujve apo gjësendeve që rrezikojnë rendin dhe sigurinë në objektet e Gjykatave. Është rreptësisht e ndaluar bartja dhe përdorimi i artikujve apo gjësendeve të përcaktuara në Shtojcën II të këtij Udhëzimi Administrativ.

### **Neni 9**

#### **Regjistrimi i hyrjeve dhe identifikimi i personave**

1. Përveç gjyqtarëve, personelit administrativ gjyqësor dhe personelit teknik të gjykatave, të gjithë personat që hyjnë në objektet e Gjykatave dhe kërkojnë qasje në hapësirat e kufizuara duhet fillimisht të regjistrohen në regjistrat e hyrjes. Të gjitha Gjykatat janë të detyruara të mbajnë regjistra, qoftë fizikë apo elektronikë (softuerikë), në të cilat bëhet regjistrimi i hyrjeve.

2. Me rastin e hyrjes në objektet e Gjykatave, të gjithë personat duhet të identifikohen personalisht përmes dokumenteve që dëshmojnë identitetin. Palët në procedurë gjyqësore dhe palët e interesuara do të pajisen me dokumente (kartela) identifikuese, që mbajnë mbishkrimin "**Palë në procedurë gjyqësore**" dhe "**Vizitor**", respektivisht.

3. Dokumentet (kartelat) identifikuese duhet të jenë të vendosura në një vend lehtësisht të dukshëm dhe duhet të barten gjatë gjithë kohës së qëndrimit të personave në objektet e Gjykatave.

### **Neni 10**

#### **Kujdesi ndaj inventarit**

1. Të punësuarit para kryerjes së orarit dhe para daljes nga zyra duhet të sigurohen për sigurinë e inventarit duke filluar nga mbyllja e dritareve, gjendjen e materialeve në zyre, heqjen nga prizma të mjeteve për nxehje, ndaljen e dritave, mbylljen e derës etj.

2. Në rastet kur të i punësuarit lind dyshimi se diçka nuk është në rregull me mjetet elektrike apo diçka e ngjashme, i njëjti paraprakisht duhet të njoftoj personelin për siguri, apo personin adekuat lidhur me sigurinë në Gjykata.

3. Pas kryerjes së orarit të rregullt të punës, personeli për siguri në Gjykatë, ka për obligim të vërtetoj gjendjen e përgjithshme të objektit të gjykatës. Kjo përfshin kontrollin në çdo kat, duke u siguruar se nuk ekziston asgjë e jashtëzakonshme.



**Neni 11**  
**Lëvizja e inventarit të Gjykatës**

Inventari i Gjykatës lejohet të futet brenda gjykatës, apo të largohet nga gjykata vetëm me autorizim të kryetarit të gjykatës ose personit përgjegjës. Lëvizja e inventarit duhet të behet gjatë orarit të punës, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

**III. QASJA NË HAPËSIRAT E GJYKATAVE**

**Neni 12**  
**Qasja dhe shfrytëzimi i hapësirave të përbashkëta në objektet e Gjykatave**

1. Të gjithë personat kanë qasje të pakufizuar dhe gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta në objektet e Gjykatave, përveç kur ajo është e ndaluar shprehimisht dhe për arsye të bazuara, dhe në bazë të një vendimi apo urdhri të personit kompetent.
2. Hapësirat e përbashkëta në objektet e Gjykatave duhet të shfrytëzohen vetëm për aktivitetet dhe qëllimet për të cilat janë dedikuar.

**Neni 13**  
**Qasja dhe shfrytëzimi i hapësirave të veçanta të objekteve të Gjykatave**

1. Qasja dhe shfrytëzimi i hapësirave të veçanta të objekteve të Gjykatave është e kufizuar, dhe lejohet vetëm nën kushtet e caktuara, me miratimin apo autorizimin paraprak të personit të autorizuar.
2. Çdo qasje dhe shfrytëzim i hapësirave të veçanta të objekteve të Gjykatave duhet të regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e personit që realizon vizitën, datën, orën dhe zyrën në të cilën është lejuar vizita.

**IV. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

**Neni 14**  
**Shpalljet publike në objektet e Gjykatave**

1. Të gjitha shpalljet publike të Gjykatave duhet të bëhen në hapësirat veçanërisht të përcaktuara për shpallje publike.

2. Të gjitha objektet e Gjykatave duhet të posedojnë hapësirën e veçantë për shpallje publike e cila duhet të jetë në formë fizike apo në formë të monitorëve elektronikë dhe duhet të jetë e dukshme për publikun.

3. Administratorët e Gjykatave janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përditësimin e rregullt të shpalljeve publike.

4. Njoftimi për mbajtjen e seancave dëgjimore/gjyqësore do të shpallet më së paku 48 orë përpara kohës së caktuar për mbajtjen e seancave.

### **Neni 15** **Komunikimi me publikun**

1. Të gjitha format e komunikimit me publikun duhet të bëhen vetëm përmes zyrtarëve të përcaktuar për komunikim me publikun. Të gjitha Gjykatat duhet të kenë së paku një zyrtar që është i ngarkuar për komunikim me publikun.

2. Me përjashtim të Kryetarëve të Gjykatave dhe zyrtarëve për komunikim me publikun, të gjithë personat tjerë duhet të përmbahen nga çfarëdo forme e papërshtatshme e komunikimit me publikun.

### **Neni 16** **Komunikimi i ndaluar**

1. Ndalohet komunikimi *ex-parte* edhe në objektet e Gjykatave.

2. Çfarëdo forme e papërshtatshme e komunikimit, qoftë formale apo jo-formale, shprehimisht apo heshtazi, ndërmjet gjyqtarëve dhe palëve në procedurë gjyqësore që ndodhë në hapësirat e objekteve të Gjykatave dhe që ngritë dyshime të arsyeshme për shkelje të rregullave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë përbën bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës disiplinore.

### **Neni 17** **Publiciteti i seancave gjyqësore**

1. Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.

### **Neni 18** **Fotografimi, audio dhe video-incizimi gjatë seancave gjyqësore**

1. Lejohet fotografimi, audio dhe video-incizimi gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore (dëgjimore) sipas legjislacionit në fuqi, pasi që për këtë të jenë njoftuar dhe pajtuar kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari individual



2. Është i ndaluar fotografimi, audio dhe video-incizimi në rast se pjesë të caktuara apo e tërë e seanca gjyqësore (dëgjimore) janë shpallur të mbyllura për publikun nën kushtet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 19**  
**Dispozitat përfundimtare**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen të gjitha dispozitat që në pikëpamje lëndore bien ndesh me këtë Udhëzim Administrativ.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

  
Skender QOÇAJ  
Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, datë 16.12.2019

### Shtojca I:

Formati dhe llojet e kartelave identifikuese për përdorim në objektet e Gjykatave:

a)	Kartela identifikuese 1 - “ <b>Gjyqtar</b> ” - i zbatueshëm për të gjithë gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave
b)	Kartela identifikuese 2 - “ <b>Personel gjyqësor</b> ” - i zbatueshëm për të gjithë personelin e gjykatës pa përjashtim
c)	Kartela identifikuese 3 - “ <b>Palë gjyqësore</b> ” - i zbatueshëm për të gjitha palët gjyqësore
d)	Kartela identifikuese 4 - “ <b>Vizitor</b> ” - i zbatueshëm për të gjitha palët e tjera të interesuara

### Shtojca II:

Lista e artikujve dhe gjësendeve të ndaluara për bartje në objektet e Gjykatave:

a)	Armët e zjarrit dhe municionet e të gjitha llojeve;
b)	Eksplzivët dhe mjetet piroteknike;
c)	Materialet radiokative dhe helmet;
d)	Substancat kimike, materialet apo gazrat e tjera të ndezshme;
e)	Substancat narkotike dhe prekursorët e tyre;
f)	Shkopinj të drurit, shufrat metalike, thikat, gërsërët apo mjetet e tjera të mprehta;
g)	Pijet alkoolike të të gjitha llojeve;
h)	Kafshët të të gjitha llojeve;